

Përgënjeshtim i Byrosë së Zhvillimit të Arsimit ndaj lajmeve të rreme të plasura në opinion në lidhje me programin *Arsimi për aftësitë jetësore në arsimin e mesëm*

Byroja e Zhvillimit të Arsimit përgënjeshton lajmet e pasakta në opinion për gjoja ekzistimin dhe përdorimin e një teksti shkollor, të cilin e përdorin nxënësit e arsimit të mesëm për zbatimin e programit *Arsimi për aftësitë jetësore*.

Megjithatë, bëhet fjalë për përpilimin e një **doracaku për mësimdhënës** bazuar në programin mësimor. Programi mësimor në fjalë është miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës, ndërsa doracaku është lejuar nga **drejtori i Byrosë së Zhvillimit të Arsimit dhe ministri i Arsimit dhe Shkencës në vitin 2011**.

Programi mësimor nuk është i detyrueshëm, përkatësisht mësimdhënësve të shkollave të mesme u jepet mundësia të zgjedhin se cilat përmbajtje (dhe në përputhje me atë cilat fletë pune), dhe në cilën periudhë të vitit shkollor do t'i realizojnë në mënyrë që t'u përshtaten nevojave të adoleshentëve.

Programi mësimor *Arsimi për aftësitë jetësore* nuk ka të bëjë me lëndë mësimore, por mund të realizohet në orën e bashkësisë së klasës me nxënësit nga viti i parë deri në vitin e katërt në të gjitha llojet e arsimit të mesëm (gjimnaz, arsimit artistik dhe arsimit të mesëm profesional).

Në programet për arsimin e mesëm (nga viti i parë deri në vitin e katërt), në temën *Jetesë e shëndoshë* janë zhvilluar përmbajtje, qëllime dhe aktivitete që kanë të bëjnë me shëndetin seksual.

Duke pasur parasysh se Doracaku (si dhe fletët e punës) dhe programi mësimor për lëndën *Arsimi për aftësitë jetësore* janë hartuar një dekadë më parë, të njëjtat do të jenë lëndë shqyrtimi nga revizioni në periudhën e ardhshme kur planifikohet reforma në arsimin e mesëm në bazë të Ligjit të ri për Arsimin e Mesëm.

Duke pasur parasysh shpejtësinë e përhapjes së lajmeve të ndjeshme dhe përgënjeshtuese në rrjetet sociale, sërish apelojmë qytetarët, e veçanërisht prindërit dhe të rinjtë që t'i marrin me shumë kujdes dhe të kontrollojnë të gjitha informacionet që shpërndahen në lidhje me arsimin e të rinjve, dhe të cilat nuk janë konfirmuar zyrtarisht nga institucionet kompetente.

Byroja e Zhvillimit të Arsimit